



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1350/5 prot.

Datë 25.07.2022

V E N D I M
Nr. 708/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur Punë*”, me Nr. REF-28961-05-13-2022, me objekt “*Rikonstruktion i hapësirave publike në bllokun e banimit në lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i Dëshmorëve*”, me fond limit 62.490.403 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK.
Adresa: Tiranë, Rruga Adem Jashari, Ndërtesa 4, Hyrja 10, Njësia Bashkiake Nr.5.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi ,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17-05-2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur Punë”, me Nr. REF-28961-05-13-2022, me objekt “Rikonstruksion i hapësirave publike në bllokun e banimit në lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i Dëshmorëve”, me fond limit 62.490.403 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e

nëntëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 08.06.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 15.06.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- Kombeas SHPK	35,316,168	lekë	skualifikuar
- Braka Construction SHPK	38,552,220	lekë	skualifikuar
- “Kevin Konstruksion” SHPK	40,802,536	lekë	skualifikuar
- “K.M.K” SHPK	41,323,952	lekë	skualifikuar
- Shkëlqimi 07 SHPK	43,000,000	lekë	skualifikuar
- “Ed Konstruksion” SHPK	43,386,472	lekë	skualifikuar
- Mela SHPK	44,515,998	lekë	skualifikuar
- MF Invest Group SHPK	46,828,451	lekë	skualifikuar
- Sterkaj SHPK	48,082,793	lekë	skualifikuar
- Eurovia SHPK	48,780,876	lekë	skualifikuar
- Euro Alb SHPK	49,502,276	lekë	skualifikuar
- Shendelli SHPK	49,987,426	lekë	skualifikuar
- Shpresa AL SHPK	49,998,097	lekë	skualifikuar
- Ardmir SHPK	51,067,492	lekë	skualifikuar
- Glavenica SHPK	52,937,616	lekë	skualifikuar
- Ina SHPK	53,362,948	lekë	skualifikuar
- Liqeni VII SHPK	55,260,394	lekë	kualifikuar
- Denis 05 SHPK	55,572,992	lekë	kualifikuar
- Desaret Company SHPK	55,794,533	lekë	kualifikuar
- BE-IS SHPK	55,888,868	lekë	skualifikuar
- Curri SHPK	58,438,118	lekë	kualifikuar
- Alges Konstruksion SHPK	59,859,063	lekë	skualifikuar
- A.L-Asfalt SHPK	59,984,782	leke	kualifikuar

II.4. Në datën 22.06.2022 operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

- Për ofertuesin “Kevin Konstruksion” ShPK Nipt: K71401004W me vlerë të ofertës 40.802.536 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimi dhe vlerësimit të dokumentacionit për

përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik Kevin Konstruksion SHPK:

1. Nuk përmbush pikën 2.3 g) për mjetet me qira Grejder, Asfaltoshtruese, mungon numri i kontratës së qirasë, afati i kontratës sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8.

II.5. Në datën 22.06.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.06.2022, operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK, ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me numër ankimi elektronik A/2022/2202 dhe me nr. 1350/2022 protokoll, datë 27.06.2022 njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1350/2 prot., datë 27.06.2022, u publikuan kriteret e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK pretendon se i plotëson.

II.8. Me shkresën nr. 132 prot., datën 05.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1350/3 prot., datë 07.07.2022, me lëndë “Në lidhje me vendimin nr. 4002/11 prot., datë 04.07.2022 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të Bashkisë Durrës, mbi ankesën e shoqërisë “Kevin Konstruksion” ShPK me numër A/2022/2305” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” ShPK ku konkretisht citoj:

“[.....]Në datën 04.07.2022 jemi njohur nëpërmjet emailit të shoqërisë me vendimin nr. 4002/11 prot., të marrë prej Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë Bashkisë Durrës.

Nga verifikimi i këtij vendimi konstatojmë se, Komisioni i Shqyrtimit të ankesave jo vetëm që nuk ka trajtuar fare pretendimet e ngritura nga ana jonë, po në mënyrë të paligjshme ka shtuar arsye të reja skualifikimi dhe konkretisht ka theksuar “Shoqëria Kevin Konstruksion” ShPK duhet të kishte plotësuar numrin e lejes së qarkullimit dhe numrit të shasisë së mjeteve grejder dhe asfaltoshtruese në shtojcën 8”, ndërkohë ankesa e ngritur nga shoqëria jonë kishte të bënte me kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të publikuara në SPE ku konkretisht kanë qenë: “Nuk përmbush kriterin 2.3 g) për mjetet me qira Grejder dhe asfaltoshtruese, mungon numri i kontratës së qirasë, afati i kontratës sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8”.

Kërkojmë të saktësojmë se KSHA-ja nuk ka kompetencat e KVO-së. Por ai ka kompetencat e kufizuara vetëm në trajtimin e pretendimeve të ngritura në ankesën e shoqërisë për të cilën kemi bërë dhe pagesën përkatëse[.....]”.

II.9. Me shkresën nr. 6006 prot., datën 06.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1350/4 prot., datë 08.07.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes konkretisht:

[.....] Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” ShPK, për arsyet e poshtëcituar:

Për ofertuesin “Kevin Konstruksion” ShPK, Nipt: K71401004W me vlerë të ofertës 40.802.536 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik Kevin Konstruksion ShPK:

- 1. Nuk përmbush pikën 2.3 g) për mjetet me qira Grejder, asfaltoshtruese, mungon numri i kontratës së qirasë, afati i kontratës sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8.*

KVO vendos që ofertuesi Kevin Konstruksion ShPK të mos kualifikohet.

Pas vlerësimit të dokumentacionit, konstatohet se:

OE “Kevin Konstruksion” për mjetet me qira Grejder, asfaltoshtruese, përveç mungesës të numrit të kontratës së qirasë, afatit të kontratës që kishte detyrimin për ti deklaruar sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8, këtij operatori i mungojnë dhe referencat që kërkohen në këtë vetëdeklarimin si: “Targa e mjetit”, nr. lejes së qarkullimit të mjetit, nr. shasisë së mjetit”, pasi edhe mjetet teknologjike grejder, asfaltoshtruese, është detyrim ligjor për t’u targuar dhe pajisur me dokumentacionin qarkullimi mjeti, ashtu siç ka deklaruar për mjetet e tjera ku i ka plotësuar të gjitha referencat e kërkuara në formularin e vetëdeklarimit.

Për sa trajtuar më lart, komisioni i shqyrtimit të ankesës,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK për kontratën me numër të referencës së procedurës: REF-28961-05-13-2022, me objekt: Rikonstruksion i hapësirave publike në bllokun e banimit në lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i Dëshmorëve”, me fond limit 62.490.403 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.10. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës të tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi se: *“Për ofertuesin “Kevin Konstruktion” ShPK Nipt: K71401004W me vlerë të ofertës 40.802.536 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimi dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik Kevin Konstruktion SHPK:*

1. Nuk përmbush pikën 2.3 g) për mjetet me qira Grejder, Asfaltoshtruese, mungon numri i kontratës së qirasë, afati i kontratës sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 6006 prot., datën 06.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1350/4 prot., datë 08.07.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues konkretisht:

[.....] Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” ShPK, për arsytet e poshtëcituarat:

Për ofertuesin “Kevin Konstruktion” ShPK, Nipt: K71401004Ë me vlerë të ofertës 40.802.536 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik Kevin Konstruktion ShPK:

1. Nuk përmbush pikën 2.3 g) për mjetet me qira Grejder, asfaltoshtruese, mungon numri i kontratës së qirasë, afati i kontratës sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8.

KVO vendos që ofertuesi Kevin Konstruktion ShPK të mos kualifikohet.

Pas vlerësimit të dokumentacionit, konstatohet se:

OE “Kevin Konstruktion” për mjetet me qira Grejder, asfaltoshtruese, përveç mungesës të numrit të kontratës së qirasë, afatit të kontratës që kishte detyrimin për ti deklaruar sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8, këtij operatori i mungojnë dhe referencat që kërkohen në këtë vetëdeklarimin si: “Targa e mjetit”, nr. lejes së qarkullimit të mjetit, nr. shasisë së mjetit”, pasi edhe mjetet teknologjike grejder, asfaltoshtruese, është detyrim ligjor për tu targuar

dhe pajisur me dokumentacionin qarkullimi mjete, ashtu siç ka deklaruar për mjetet e tjera ku i ka plotësuar të gjitha referencat e kërkuara në formularin e vetëdeklarimit.

Për sa trajtuar më lart, komisioni i shqyrtimit të ankesës,

Vendosi

I.Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK për kontratën me numër të referencës së procedurës: REF-28961-05-13-2022, me objekt: Rikonstruksion i hapësirave publike në bllokun e banimit në lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i Dëshmorëve”, me fond limit 62.490.403 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.[...]”.

III.2.Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori

Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të	Po []

Ofertuesit;	
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur	Po [] Jo []

<p>marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me</p>	<p>Po [] Jo []</p>

prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i

Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të	Po [] Jo []

paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit**.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë

të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3 g “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi të modifikuara përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Lloji i makinerive</i>	<i>Sasia</i>
<i>Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton</i>	<i>1 copë</i>
<i>Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton</i>	<i>2 copë</i>
<i>Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton</i>	<i>2 copë</i>
<i>Greider</i>	<i>1 copë</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>2 copë</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>1 copë</i>
<i>Fadrom me goma</i>	<i>1 copë</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 copë</i>

<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>
<i>Kamion me cisternë ujë</i>	<i>1 copë</i>
<i>Rul me vibrim</i>	<i>1 copë</i>

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si: leja e qarkullimit, Certifikatat e kontrollit teknik, foto e mjetit (për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të disponojë dokumente që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/të dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, ku në Deklaratën C “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë. Mjetet e poshtëshënuara pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. Në pronësi :Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.49 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 32 ton, minieskavator, fadromë me goma:

- **Me qira:** Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 5.99 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 42 ton, grejder, ekskavator me goma, ekskavator me goma, asfalto shtruese, autobetoniere, autobot uji, autobot uji, autobot uji, rul me vibrim, rul me vibrim, rul me vibrim.

III.2.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.5. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.7. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: **“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/entit kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/entit kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3 g) “Kapaciteti teknik” të dokumenteve standarde të tenderit të modifikuara për disponimin e 1 (një) Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5- 7.5 ton, 2 (Dy) automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5 -18 ton, 2 (Dy) automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton , 1 (një) Greider, 2(dy) ekskavator me goma, 1(një) minieskavator, 1(një) fadromë me goma, 1(një) asfaltshtruese, 1(një) autobetoniere, 1(një) kamion me cisternë uji, 1(një) rul me vibrim, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, ku në

Deklaratën C “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë. Mjetet e poshtëshënuara pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. **Në pronësi** :Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.49 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 32 ton, minieskavator, fadromë me goma:*

- **Me qira:** Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 5.99 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 42 ton, grejder, ekskavator me goma, ekskavator me goma, asfalto shtruese, autobetoniere, autobot uji, autobot uji, autobot uji, rul me vibrim, rul me vibrim, rul me vibrim.

Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin se *Për ofertuesin “Kevin Konstruktion” ShPK Nipt: K71401004W me vlerë të ofertës 40.802.536 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimi dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik Kevin Konstruktion SHPK:*

1. Nuk përmbush pikën 2.3 g) për mjetet me qira Grejder, Asfaltoshtruese, mungon numri i kontratës së qirasë, afati i kontratës sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca nr. 8.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka ngarkuar në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, ku në Deklaratën C “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë. Mjetet e poshtëshënuara pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. **Në pronësi** :Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.49 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 32 ton, minieskavator, fadromë me goma:*

Me qira: Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 5.99 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 18 ton, automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 42 ton, grejder, ekskavator me goma, ekskavator me goma, asfalto shtruese, autobetoniere, autobot uji, autobot uji, autobot uji, rul me vibrim, rul me vibrim, rul me vibrim, në lidhje me përmbushjen e kriterit mbi disponimin

e mjeteve të kërkuara për realizimin me sukses të procedurës objekt-shqyrtimi. Për sa i përket mungesës së numrit të repertorit të kontratës së qirasë dhe të afatit të kontratës sipas Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) rezulton se operatori ekonomik ka dhënë indicie që ka nënshkruar kontratë qiraje me subjektin Geci, duke vërtetuar disponueshmërinë e mjeteve, mjetet grejder dhe asfaltoshtuese për të gjithë kohën e nevojshme që kërkohet për të kryer punimet. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu, nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik pranë institucioneve kompetente ose t'i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime operatorit ekonomik. Në rastin konkret autoriteti kontraktor Bashkia Durrës nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, apo të kryejë një hetim të thelluar për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimes nuk e plotëson këtë kriter.*

Gjithashtu, sipas shtojcës 12 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklarata do të bëhen *në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”*. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar

rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. *KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë bërë një hetim të thelluar apo verifikim për mjetet dhe dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik për justifikimin e tyre pranë organeve kompetente.* Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimes nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,** si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit në këtë fazë, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur Punë”, me Nr. REF-28961-05-13-2022, me objekt “Rikonstruktion i hapësirave publike në bllokun e banimit në lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i Dëshmorëve”, me fond limit 62.490.403 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri